

ARBËR ARAPI
KU JE TI SOT?
POEZI, PROZA, PËRKTHIME

BOTIMET TOENA

ARBËR ARAPI

KU JE TI SOT?

Poezi, proza, përkthime

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817167

©Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

... mbase hapat e parë të një rruge të gjatë...

Parathënie

Ka të ngjarë që akti i krijimit poetik, të fillojë nga ideja që shprehja artistike nuk është diçka artificiale apo e lindur, por drejtimi i natyrshëm në jetën e secilit prej nesh. Një drejtim që duhet të zbulohet përtej pasigurisë dhe frikës, ku hapat që hedhim mund të jenë këmbëngulje për të përqafuar botën duke filluar nga jeta jonë. Nuk ka nevojë për shtjellime të habitshme apo kthesa të menjëhershme në këtë rrugëtim, mjafton të dëgjojmë zërin brenda vetes, në kohën kur poezia vjen e depërton ngadalë, derisa hapet plotësisht në shpirtin dhe ekzistencën e gjithsecilit. Bëhet fjalë për fitimin e një hapësire të çmuar, të një dimensionit ku mund të jemi vetvetja. Këtë lloj hapësire, këtë lloj lirie, e gjejmë te libri i parë i poetit Arbër Arapi, “Ku je ti sot?”, ku identiteti krijues i autorit ushqehet me esencën e ndjenjës, të përjetimit, të kujtimit, mallit, dëshirës, pasigurisë, derisa i dorëzohet plotësisht intimitetit të zemrës dhe dashurisë. Poezia që shpërfaqet në këtë përmbledhje poetike është e identifikueshme si diçka që mund të matet dhe të peshohet, përngjan me ngjitjen e

shkallëve drejt sublimes, sepse në çdo rast esenca poetike ushqehet nga ndjenja e mirëfilltë, që i jep kuptim dhe ekuilibër jetës. E veçanta e këtij libri përkon edhe me përmbajtjen e veprës: kemi poezi, por edhe proza e përkthime, pa lënë pas dore krijimtarinë origjinale të artistit, piktorit dhe skulptorit popullor Selaudin Arapi, babait të autorit, i cili është ndarë nga jeta fizike, por jeton përmes kumtit artistik që ka lënë si trashëgimi e përhershme në këtë botë. Prania e artistit Selaudin Arapi, që fatkeqësisht ka ndërruar jetë në vitin 2013, është e prekshme në shumë poezi të përfshira në këtë libër dhe synon të përjetësojë një model dhe një ndjenjë që ushqehet nga shpirtërorja dhe që nuk njih kurrë mpakje e perëndim. Ndoshta ky element, bën që libri në thelb të jetë edhe një dedikim ndaj figurës atërore, por edhe një përmbushje misioni, pas një kohe të gjatë të materialeve të përpunuara brenda vetes, sepse krijimet dhe përkthimet e këtij libri datojnë në periudha të ndryshme kohore, e shpeshherë kanë si kohë kur janë shkruar edhe fillimin e viteve 2000. Ky kompozim i librit, i mundëson lexuesit të njohë një botë thellësisht personale, të mbushur me përjetime, dhimbje, dashuri, mall, filozofi, që shënjon ekzistencën e autorit, që është vetë bota dhe jeta e autorit, por që tanimë i zgjeron kufijtë përtej intimes e synon të afrojë edhe ata që kanë ngacmime të ngjashme brenda vetes. Këto elemente kompozicionale, shërbejnë për të kuptuar strukturën e veprës, por edhe përzgjedhjen paraprake

të realizuar nga autori për të përfshirë thelbësoren dhe atë që është më e rëndësishme dhe me vlerë në sytë e tij, brenda tekstit.

Në fillim të librit autori ka zgjedhur të shkruajë: “... *mbase hapat e parë të një rruge të gjatë...*”, që të bën të mendosh që më në fund ai e ka kuptuar që kjo është rruga e tij, nuk ka më kthim pas dhe letërsia mund të jetë i vetmi orientim, hapësira ku ai mund të shquajë ekzistencën e vet të realizuar. Poezia që çel librin ka një titull metaforik: “Kur zemrën i theve nënës, mungoi dhe dritë e Hënës!”, përcjell ndjenjën dhe lidhjen universale të nënës me birin, e megjithëse intime, ka një subjekt që ilustron gabimet e fëmijëve që falen përherë nga dashuria e nënës:

*Qielli derdhi e kulloi dritë, në prehrin e së gJORËS,
e ca qortime djalit ia la plumb n'pëllëmbë të dorës!
O gjak, o djalë, o burrë, o bir i mirë i mëmës,
kur zemrën i theve nënës, mungoi dhe dritë e Hënës!*

Nga ndërtimi i kësaj poezie, marrim modelin si do të jenë poezitë e tjera të këtij libri: me varg të rregullt, rimë të puthur. Poezia “Ku je ti sot?”, fill pas poezisë hyrëse për nënën, i kushtohet kujtimit të babait, ngre një pyetje që është ekzistenciale dhe ka shoqëruar njerëzimin që në ngjizje të tij; ç'bëhet me shpirtin, kur njeriu largohet nga kjo botë? E ato ndjesi që kemi brenda vetes, që lidhen me kujtimet e dashura për ne, a gjejnë jehonë tek kupola e qiellit, në fronin e

Perëndisë, ku mblidhen të dëlirët dhe të mirët e ikur
të kësaj bote?

Ku je ti sot?

*Të kërkova në net, në ditë, në muaj,
në shira vjeshte që më duken të huaj,
në shtrëngata vuajtjeje, në shtigje dëlirësie,
në akrepa orësh, në grimca mirësie!*

Ngarkesa emocionale është e prekshme në këtë poezi të shkruar në tetor të vitit 2013, po atë vit kur është ndarë nga jeta babai i autorit. Poeti kërkon një dialog të munguar, synon të mbajë gjallë një lidhje që tanimë duket e pamundur, por që ushqehet nga dashuria që nuk vdes asnjëherë. E njëjta lidhje shpirti pasqyrohet edhe te poezia “Jetë këputur në pranverë”, por në këtë rast nevoja për të gjetur një arsye, për të kërkuar një shpjegim, është si trokitje në portën e madhe të misterit ku askush nuk të përgjigjet. Të gjithë do ta provojmë ta kapërcejmë atë prag kur të vijë momenti, e askush nuk është në gjendje të shpjegojë çfarë ndodh e si është bota përtej:

*Dielli mbi sy më nuk u zgjua,
n’lulëzim prilli, zemra u shua,
kthehu ti, o babi, eja dhe një herë,
dimri i shpirtit të na bëhet verë.*

*Eja shihi zogjtë tek gëlojnë,
eja puthi lulet kur gjallojnë,
më sill një shportë me kujtime,
... dikur ishe vetvetja ime...*

Në këto strofa, përmbledhet një dhimbje që vetëm akti i krijimit mund ta lehtësojë pak. Ti shkruan, e kujtimet e tua kthehen në një realitet që do të jetojë edhe kur ti të mos jesh më. Bota letrare zëvendëson botën njerëzore, e ndoshta ky është çelësi me të cilin kërkon të ekuilibrojë ekzistencën autori i librit. Ndaj autori vijon me këtë nevojë për t'i dhënë përligje letrare humbjes së babait, me poezitë: “Jetë këputur në pranverë”; “Pranverë e hidhur”; Babit; “Të t’shoh atje, ku shpirti thyhet”; “Vdiq një trup, por jo një shpirt!” Këto poezi përbëjnë një cikël që lidhet me figurën atërore, e shenjtërojnë dhimbjen dhe përjetësojnë kujtimin.

Më tej, shohim që gjurmë të tilla përfytyrimi, zëvendësohen nga dashuria, humbja, mungesa e saj dhe një melankoli që përjetohej dukshëm mes vargjeve. Poezitë krijohen mbi vargje që shtrohen si hapa për lexuesin, duhet të shkelësh aty ku ka shënjuar poeti, për të kuptuar brishtësinë dhe dhimbjen e tij, për të vështruar përtej, drejt një qielli dhe një kohe ku lexohen fragmente nga shpirti i njeriut. Gjithçka ngjan të jetë delikate dhe e qelqtë brenda këtij libri, mëngjeset me agimin e tyre dhe mbrëmjet me errësirën e varur në qiell, pjesë të një bote ku qetësia më e vogël

shndërrohet në padurimin që heshtja të marrë fund. Liria, kjo eksperiencë e pakrahasueshme e jetës, në një botë ku po shtohen ata që zgjedhin me vetëdije të mos guxojnë, të mos kërkojnë, të mos provojnë atë që është dashuri dhe bekim. Autori dëshiron, ndien, dashuron, por prania e tjetrës është larg, ka ikur, ka humbur, vonon. Kjo melankoli e lë në pritje, por jo pasiv, ai përfytyron dhe evokon me forcën e imagjinatës gjithçka që mund të lidhet me figurën e së dashurës, me nevojën për ta pasur atë pranë vetes. Poezitë ku rima nuk është kusht ose mungon fare kanë forcë dhe çlirim, por edhe komunikim më të bukur e më të drejtpërdrejtë.

Nostalgjia

*Psherëtinë yjet
kur ndjenë frymën tënde,
dhe vesa e trëndafilut
u zhduk përtej horizontesh;*

*kur drita e syve
me hënën vjeshtore u kryqëzua,
në gjethe në gjethe
fshihej portreti yt...*

Ndoshta ky është stili që e rrëmben më lirshëm interesin e lexuesit, sepse zotëron një forcë imagjinatë dhe mendimi që nuk ka nevojë të kufizohet nga ligjet e metrikës:

E ç'është një copëz jetë?

*... një copë dheu
i përbaltur nga shirat e vjeshtës,
nga furtuna e marsit,
nga dimri i egër.*

*Një kristal i thyer,
pllakë xhami e shkërmoqur,
një rrëke, një lumë, një det,
një mori kujtimesh, një rrjedhë.*

Një tjetër nga ndarjet e rëndësishme të librit, përkon me përkthimet dhe përshtatjet e autorëve të njohur të letërsisë botërore, si Lord Bajron, Xhon Kits, Pablo Neruda, Oskar Uajlld. Poezitë e zgjedhura, përkojnë me natyrën e librit, kanë format intim, lirik, sentimental dhe përshtatja e tyre është në përputhje me elementet stilistikore që autori përdor në krijimtarinë e tij. Këtu kemi një përpjekje për t'i qëndruar besnik origjinalit, por edhe një përvetësim të lirë të aktit të përkthimit si një akt rikrijimi letrar. Ndaj, fakti që autori merr përsipër të flasë për përshtatje e jo vetëm shqipërim të poezive, i jep një lloj tolerance që mund të mirëkuptohet nga lexuesi.

Një ndarje tjetër janë “Prozat poetike”, ku gjuha e autorit është me figuracion, nuk i ndahet motiveve që gjallojnë edhe në poezinë e tij dhe nuk është një prozë veprimi, ku tregohet, por një prozë

gjendjeje (shpirtërore) që ecën paralel me ndjesitë e brendshme të autorit. Edhe këtu kemi mallin, dëshirat e paplotësuara, lidhjen me figurat e shenjta të jetës së njeriut: motrën, nënën, babain. Por edhe dhënien pa kursim të vetes ndaj dashurisë, zhgënjimit dhe emocionit që gjallon në këto dy skaje.

Në përfundim, mund të theksojmë se poetika e krijuesit Arbër Arapi shtron një sipërfaqe të ndjeshme, duke shpalosur një botë dhe objekte që nuk ndalen kurrë në një formë të pandryshueshme; ato veprojnë sipas vullnetit të krijimit artistik. Në vëmendjen e tij ndaj jetës, ai shpreh admirimin për mrekullitë dhe ngjarjet e jetës, duke e kuptuar atë si një detyrim për të ndryshuar perspektivën tonë ndaj realitetit. Ai ka aftësinë të dalë nga zakonet dhe rutina e përditshme dhe i përdor emocionet dhe ndjenjat si mjet për të shpëtuar lexuesit nga monotonia dhe trishtimi i përsëritur në jetën e tyre të përditshme. Libri, nën këtë trajtë, i drejtohet drejt zemrës së lexuesit të kujdesshëm dhe intelektit të atyre që janë të dhënë pas përfytyrimit emocional, për të kërkuar çlodhje dhe kënaqësi tek e bukura e fjalës artistike.

Prof. as. dr. Eris Rusi

POEZI

**Kur zemrën i theve nënës,
mungoi dhe dritë e Hënës**

Bir!
Ki mëshirë!
Për shpirtin e trazuar,
ti mos lëndo një zemër,
nga jeta të dërrmuar!

Bir!
Ki mëshirë!
Për qumështin e mëkuar!
Kaq shpejt, vallë, o bir
e paskërke harruar,
që falë atij qumështi,
je rritur dhe burrëruar?

Kujtoje veten kur zure shtratin,
kur sëmundja po t' digjte shtatin,
e kur askush s'ta qante hallin,
te buzët e nënës e afrove ballin.

Kur gjoksi valë-valë fërgëllonte,
digjej prush i ethshëm mërzie,
në sytë e brishtë shikoje,
qiej të kaltër prilli, dete dashurie.

Në vështrim të syve, n'shikim të gëzimit,
lundronte qetë e lehtë, anija e shpëtimit;
të dhuroi ty jetën, t'dha penën e poetit,
të fali vetë zemrën dhe shpirtin e artistit.

Qielli derdhi e kulloi dritë, në prehrin e së gjorës,
e ca qortime djalit ia la plumb n'pëllëmbë të dorës!
O gjak, o djalë, o burrë, o bir i mirë i mëmës,
kur zemrën i theve nënës, mungoi dhe dritë e Hënës!

E mpakur nga marazi;
brenda në kraharor, zemra si s'i plasi?

E hesht djaloshi e nis të qajë,
sytë pikë-pikë vërshonin vaj,
u drodh dhe veten nuk mundi,
jo, s'mundi ta mbajë,
kur ballin uli në prehrin e saj.

Nga ethe të pendimit nisi t'psherëtijë,
e me zë në gojë sakaq të thotë:
- Sa rrahje, oh, zemra mua do të më pulsojë,
aq herë do të lus Zotin ty të t'mëshirojë!

Ku je ti sot?

Të kërkova në net, në ditë, në muaj,
në shira vjeshte që më duken të huaj,
në shtrëngata vuajtjeje, në shtigje dëlirësie,
në akrepa orësh, në grimca mirësie!

Ç' dallgë të ëmbla sot ty shpirtin ta lëmojnë?
Ku zemër fisnike dhe sytë e qeshur valëzojnë?
Ti mes nesh do të jesh sot edhe përherë,
në zemrën tënde do të ketë gjithherë pranverë!

Ti lë pas një hov të epur, një mall të lazduar,
një degë shprese, një shpresëmall t'përvëluar;
kumbove thellë në shpirt, ti nur i paharruar,
akoma jehon nostalgji, ëndërr e përmalluar!

Shkove dhe s'u ktheve më,
ike në përjetësi,
u nise drejt një udhe të përndritshme
krenari e paarritshme...!

Ike si yll i bukur, i qetë, si gjithçka e parë
e prekur, e puthur, e tretur,
në këtë botë në këtë jetë,
vetëm trupi të mbeti i vdekur!

Si ike..., si pezmatim gëzimi,
si tis shprese, si tis rrëzëllimi,
si sythi i luleve në fillim të majit,
si dhimbja-tretur, si kënga e vajit!

Si dritë, si magji nate, si lumturi jete,
si ëndërr e bukur mes nesh ti mbete,
si zogu n'zabele, si gjaku ndër deje,
o ba', si ike pa leje, si ike prej meje!

U ktheve tek Ai që të solli në jetë,
përsëri u riktheve te Zot i Vërtetë!

Dhe mbete...

... dhe mbete...

një ëndërr e thyer,
një ëndërr me ndjenja ngijer,
një dëshirë e pamohuar,
një dallëndyshe e vonuar;

... dhe mbete...

një zog që fluturimin s'e mori,
një libër i palexuar,
një histori e patreguar,
një copë qiell, një copë diell;

... mbete...

një pjesë e imja që s' ishte e imja,
një pjesë e imja që e imja s'u bë,
një lulëkuqe në ara plot me grurë,
një filiz, një lule që nuk çeli kurrë;

... mbete...

një poezi e saponisur,
një ëndërr e grisur,
një perëndim në det,
një shkrim në fletë,
një valë e ëmbël,
aromë pylli, aromë bliri.

... mbete...

në agime të arta larë me ar,
një ëndërr e gjetur,
një ëndërr e prekur,
një ëndërr e tretur;

... mbete...

një copë bukë e kafshuar,
nga dy duar e dhuruar,
mbete një zarf i postuar,
një lot i lagur në zarf të hapur,
një fjalë, dy sy;

... mbete....
në natë të gjatë,
në ditë, në dritë,
një poezi e saponisur,
ëndërr e shprishur,
një libër i palexuar,
një histori e patreguar...

Jetë këputur në pranverë

Kur lauresha ia merr këngës në maj,
kur dhe zëri i bilbilit të duket si vaj,
zemra në shtrat dergjet, pulson e rënkon,
s'e sheh dot pranverën kur nis e gjallon.

Jeto, o jetë, jeto shpenguar,
larg zinxhirësh të pranguar,
dritë, o dritë, o jetë dhuruar,
puthe pranverën e praruar.

S'i pe lëndinat kur bleruan,
dhe as zë qyqet kur vajtuan,
bilbilat s'dëgjove kur kënduan,
trupi përzhitet, rrëgjohet dhe vuan.

Pate dëshirë jete të pasosur,
por sot qëndron nën dhé varrosur,
pranverë e ngrohtë të malloi,
por dhé i tokës të mbuloi.

Dielli mbi sy më nuk u zgjua,
n'lulëzim prilli, zemra u shua,
kthehu ti, o babi, eja dhe një herë,
dimri i shpirtit të na bëhet verë.

Eja shihi zogjtë tek gëlojnë,
eja puthi lulet kur gjallojnë,
më sill një shportë me kujtime,
... dikur ishe vetvetja ime...

Pranverë e hidhur

Të luftosh me jetën, në shtrat me shpirtin lidhur,
ta pish gllënjë-gllënjë pranverën e hidhur,
t'i thuash lamtumirë me zërin e ngjirë,
me shpirt të vrarë dhe me zemër të grirë

Të mos kesh as forcë të mendosh rininë,
të mos i shohësh dallëndyshet në pranverë kur vijnë,
të ndiesh pafuqinë që të plas xhanë e gjinë,
t'mos shikosh as zogjtë kur në degë qershie rrinë.

Si ndihet një njeri kur zemra po i tretet,
kur në trup të tij veç helm i hidhur mbetet?
Vallë, ç'ëndrra të bukura ty të patën parë,
ç'momente të trishta atë e patën vrarë?

Si ndihet njeriu kur jeta po i këputet,
dhe në heshtje vështron, rri edhe lutet?

E sheh si të shuhet jeta, midis shtratit dhe shpresës,
dhe ndien se si fikesh, mes një dhimbjeje dhe tjetrës,
mbi tokë ku ne gëzojmë si mundemi të harrojmë,
se eshtrat e kokallat nën dhé ty të qëndrojnë?

Ç'pasionë të zjarrta të patën lumturuar,
ç'vuajtje e ç'heqje e patën fort munduar?
*I shpërthente jeta në duar, në gishta e në sy,
se veç një qe babi dhe s'mund të jetë dot dy.*

Babit...

Pse kaq e vrarë fytyra jote,
më sheh me sytë plot pikëllim,
m'shikon me sytë e lëngëzuar,
sikur më nesër s'do t'ketë agim?

Pse kaq e heshtur kjo fjala jote,
që del nga goja ëmbëlmjaltë,
në zemër lotët t'janë vargëzuar,
pse kaq trishtim në sytë e zjarrtë?

Ç'po sheh atje në qiell të kaltër,
kokën lart përse e mban?
Ç'e mundon zemrën e vuajtur,
pse n'lule të prillit syri qan?

Po m'dukesh shumë i lodhur,
fare, krejt i raskapitur,
ç'po të mundon shpirtin e lodhur,
përse je kaq i drobitur?

Jetë e jetës të mundoi,
por mendjen krenare nuk ta shoi,
jepmë mua atë dhimbjen tënde,
t'provoj dhe unë atë gjendje.

Shkruaje vuajtjen në një fletë,
që të shtrihet e gjerë si det,
ta dijë dhe bota mbarë krejt,
se ç'hoqi e ç'vuajti shpirti i shkretë.

S'do të mundesh të vish n'varrimin tim.
Përherë do të mbetesh Heroi im...!